



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

PAKETË INFORMUESE PËR LETONINË

1. Informacioni bazë

Kryeqyteti: Riga
Popullsia: 2,270,700
Sipërfaqja: 64.589 km²
Monedha: Lats (LVL)
Niveli i Papunësisë: 4.5%

2. Kushtet e përgjithshme të hyrjes dhe informacioni për vizë

Vizat mund të jepen në misionet diplomatike dhe poste konsullore të Republikës së Letonisë:

Ambasada e Letonisë për **Shqipërinë** (Romë, Itali)

Viale Liegi, 42, 00198 Rome, Italy

tel: (39) 0 688 41 229

fax: (39) 0 688 41 239

e-mail: embassy.italy@mfa.gov.lv

Faqe interneti: <http://www.mfa.gov.lv/rome>

Seksioni konsullor:

Tel: (39) 0 688 41 237

Përfaqësimi konsullor i Letonisë për **Bosnjën dhe Hercegovinën, Serbinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë**

Ambasada e Letonisë në Gjermani

Reinerzstr. 40-41, 14193 Berlin, Germany

Tel: (49) 30 82 60 02 22

fax: (49) 30 82 60 02 33

e-mail: embassy.germany@mfa.gov.lv

Faqe interneti: <http://www.am.gov.lv/berlin>

Seksioni Konsullor

Tel: (49) 30 82 60 02 11

fax: (49) 30 82 60 02 44

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



Ambasada e Letonisë për **Kroacinë** (Pragë, Republika Çeke)

3 Hradeshinska Street, 10100 Prague

Tel: (420) 255 700 881

fax: (420) 255 700 880

e-mail: embassy.czech@mfa.gov.lv

Faqe interneti: <http://www.prague.am.gov.lv/>

Seksioni Konsullor:

Tel: (420) 255 700 882

Seksioni Konsullor në Zagreb

Petrinjska 28/II, 10000 Zagreb

Tel: (385) 1 4852717

fax: (385) 1 4852718

e-mail: info@latvia-consulate.hr

Vizat transit (A, B):

Viza e transitit në aeroport (A) ju lejon të kaloni transit përmes një aeroporti ndërkombëtar në zonën Shengen pa hyrë në territorin e Shengenit. Shtetasit e Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, Kroacisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë nuk kanë nevojë për vizë transiti në aeroport (A).

Viza e transitit (B) jepet për periudhë 5 ditore për të kaluar transit përmes territorit të Shengenit nga toka.

Vizë Shengen për qëndrim afatshkurtër (C):

Meqë Letonia është Shtet Anëtar i Marrëveshjes së Shengenit, viza letone e hyrjes i jep të drejtë mbajtësit të saj të hyjë në të gjithë zonën Shengen. Viza për qëndrim afatshkurtër (C) lejon mbajtësin e saj të qëndrojë deri në 90 ditë në territorin e Shengenit në një periudhë 180 ditore për qëllime turizmi, familjare ose biznesi.

Shtetasit kroatë nuk kanë nevojë të aplikojnë për vizë për qëndrim afatshkurtër (C). Shtetasit e Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë i nënshtrohen kërkesës për vizë. Bazuar në Marrëveshjet për Lehtësimin e Vizave dhe në Marrëveshjet e Ripranimit ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, shtetasit e këtyre vendeve duhet të kërkojnë vizë C Shengen për të hyrë në Letoni; megjithatë ata përfitojnë një tarifë të reduktuar vize (35 Euro në vend të 60 Euro). Shumë kategori të aplikantëve (familjarë të shtetasve rezidentë të ligjshëm, studentë dhe pensionistë, gazetarë etj) tani mund të marrin gjithashtu viza falas.

Për kategori të caktuara personash p.sh. tregtarë, studentë dhe gazetarë, kërkesat për dokumentacion do të thjeshtohen. Disa kategorive të personave që udhëtojnë shpesh (përfshirë këtu tregtarë, gazetarë, studentë, përfaqësues të shoqërisë civile) do t'u jepen viza me shumë hyrje për periudha të gjata vlefshmërie dhe mbajtësit e pasaportave diplomatike do të përjashtohen nga detyrimi për vizë.

Shihni hollësitë në:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0085:0095:EN:PDF> (për Shqipërinë)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0097:0107:EN:PDF> (për Bosnjë Hercegovinën)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0125:0135:EN:PDF> (për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0137:0147:EN:PDF> (për Serbinë)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0109:0119:EN:PDF> (për Malin e Zi)

Për të aplikuar për vizë qëndrimi afatshkurtër (C) duhet të dorëzoni:

1. formular aplikimi (http://www.am.gov.lv/data/file/l/anketa_lv-eng_sengena.pdf)
2. 2 fotografi pasaporte
3. pasaportë të vlefshme

4. biletën e kthimit ose një rezervim hoteli në rastin e hyrjes për qëllim turizmi
5. dokument vërtetues në lidhje me qëllimin e udhëtimit (për detaje të dokumenteve specifike të kërkuara kontaktoni ambasadën më të afërt me ju)
6. vërtetim të mjeteve të mjaftueshme financiare për të mbuluar kostot e udhëtimit

Mbajtësit e lejes së qëndrimit për në Letoni mund të udhëtojnë nëpër territorin e Shengenit pa patur nevojën të aplikojnë për vizë Shengen.

Vizë afatgjatë (D)

Një vizë afatgjatë (ose leje qëndrimi) është e vlefshme vetëm për qëndrimin në Letoni. Kjo vizë gjithashtu është e vlefshme për të kaluar shtete të tjera të Shengenit në kalim transit për të arritur në Letoni. Një vizë afatgjatë i jep mundësi mbajtësit të saj të qëndrojë në Letoni më shumë se 90 ditë në një periudhë gjysmë vjeçare sipas rrethanave.

Për të aplikuar për vizë afatgjatë, duhet të dorëzoni:

1. pasaportë ose dokument tjetër udhëtimit (që ka të paktën dy faqe bosh dhe me periudhë vlefshmërie të pasaportës që është më e gjatë se ajo e vizës me të paktën tre muaj)
2. Formular i aplikimit për vizë i plotësuar dhe i firmosur nga aplikanti (http://www.am.gov.lv/data/file/l/Vizas_anketa_ENG.pdf)
3. 1 fotografi me ngjyra (35mmX45mm)
4. policë sigurimi shëndetësor për udhëtim të vlefshme në të gjitha vendet e Shengenit për të gjithë periudhën e vizitës tuaj në zonën e Shengenit (shuma minimale e sigurimit është 30 000 Euro)
5. pagesë ose konfirmim të pagesës së tarifës së aplikimit për vizë
6. dokumente mbështetëse që justifikojnë qëllimin dhe kushtet e vizitës. Zyrat konsullore do të vendosin cilat dokumente mbështetëse duhet të dorëzoni. Mund t'ju kërkohet të jepni dokumentacion për sa më poshtë:
 - qëllimin e hyrjes (për shembull, ftesë të miratuar nga Zyra e Çështjeve të Shtetësisë dhe Migracionit)
 - mjetet e transportit (për shembull, bileta vajtje-ardhje ose rezervim i biletave)
 - mjete jetese për të qëndruar në të gjitha vendet e Shengenit që do të vizitoni dhe mjetet për t'ju kthyer në vendin e qëndrimit (për shembull raport të llogarive bankare për transaksione gjatë muajve të shkuar);
 - vendin e qëndrimit në Letoni (për shembull ftesën të miratuar nga Zyra për Çështje të Shtetësisë dhe Migracionit nëse i huaji qëndron tek pala që e fton ose rezervim hoteli);
 - lidhje me shtetin e qëndrimit (për shembull një letër nga punëdhënësi, institucioni arsimor, diplomë profesionale ose akademike)

Për informacion tjetër më të detajuar se çfarë dokumente kërkohen për situatën tuaj specifike, ju lutemi të kontaktoni ambasadën ose konsullatën letone më të afërt.

3. Imigracioni për qëllime punësimi

Nëse jeni nga një shtet që nuk është anëtar i Bashkimit Europian duhet të merrni një vizë ose leje pune për të punuar në Letoni. Shtetasit e disa vendeve mund të vizitojnë Letoninë deri në tre muaj pa vizë, por do t'ju duhet një vizë ose leje pune për të filluar punësim.

Nëse do të qëndroni për një periudhë më të gjatë kohore ose synoni të studioni ose punoni në Letoni duhet të kontaktoni me Ambasadën në lidhje me kërkesat për vizë. Për më shumë informacion për vizat që mund të jepen kontaktoni ambasadën ose konsullatën letone më të afërt ose vizitoni faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Letonisë (<http://www.am.gov.lv/en/>)

a) Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve të huaj

Shtetasit e huaj duhet të marrin një leje pune përpara se të angazhohen në punësim në Letoni. Përpara fillimit të një kontrate punësimi, duhet të merrni një leje pune:

Për një marrë një leje pune, ju duhet:

- Të paraqisni një kontratë punësimi me një biznes të regjistruar në Letoni

- Përpara se të filloni të punoni me kontratë punësimi, duhet të paraqisni leje të vlefshme pune dhe të bashkëngjisni një "leje qëndrimi" ose vizë të veçantë tek kontrata e punësimit.

Një leje pune nuk kërkohet për:

- Menaxherët që nuk janë palë të autorizuar nënshkruese të një kompanie që përfaqëson një firmë të huaj
- Aksionerët, që nuk janë palë të autorizuar nënshkruese të kompanive të regjistruara në Letoni
- Mbajtësit e lejeve të qëndrimit të përhershëm

b) Sektorët e tregut të punës që kanë mangësi

Zanatet dhe profesionet e mëposhtme vuajnë më shpesh mangësi pune: punëtorët e ndërtimit, saldatorët, shoferët e automjeteve të kategorisë C, E, dhe D, mekanikë automotivë, doktorë/infermierë, rrobaqepës, auto-elektricitë, menaxherë të punëve të ndërtimit, shoferë të makinerive të ndërtimit të rrugëve dhe traktorëve dhe shitës.

Sipas rezultateve të Sondazhit të Punëdhënësve të kryer nga Agjencia Shtetërore e Punësimit në fillim të 2008, një rritje në numrin e punëmarrësve pritet në tregtinë me shumicë dhe pakicë dhe në sektorët e riparimit të automobilave, motoçikletave, mallrave personale dhe pajisjeve shtëpiake; megjithatë, në përgjithësi, prognoza e nivelit të punësimit mbetet në të njëjtin nivel.

Ulja e papunësisë lidhet me rritjen e shpejtë ekonomike në Letoni. Produkti i Përgjithshëm Bruto u rrit me një mesatare 8.1% në vit në periudhën nga 2001 deri në 2005, 10.2% në 2005, 12% në 2006 dhe 10.2% në 2007. Këto janë normat më të larta në Bashkimin Europian. Zhvillimi ekonomik bazohet kryesisht në sektorin e shërbimit. Ndërtimi, transporti, shërbimet e komunikimit dhe tregtisë kanë pasur bum në krahasim me sektorë të tjerë të ekonomisë kombëtare.

c) faqe interneti për të kërkuar punë

<http://www.jobsabroad.com/Latvia.cfm>

http://www.anyworkanywhere.com/visas_lv.html

<http://www.labourmobility.com/files/guides/Latvia.pdf>

4. Imigracioni për qëllime studimi

a) Sistemi leton i arsimit të lartë

Procedura e pranimit në programe letone të studimeve të larta nuk është e centralizuar, çdo institucion i lartë arsimor ka bordin e tij të pranimit. Institucionet mund të organizojnë një ose më shumë provime konkurruese për pranime. Në disa raste, nëpunësit e pranimeve kryejnë dhe intervista. Procedura e pranimit të studentëve ndërkombëtarë nga shtetet anëtare të BE-së është e njëjtë si për studentët letonë. Pranimi i studentëve nga vendet Baltike bëhet sipas Marrëveshjes Baltike të Njohjes. Rregulla të ndryshme pranimi mund të zbatohen nga vende të tjera.

Institucionet e larta arsimore që nuk janë të llojit universitar ofrojnë programe profesionale ndërsa institucione të larta arsimore universitare ofrojnë programe studimi akademike dhe profesionale.

Arsimi i lartë akademik ofron diploma universitare (Bakalaurs) dhe Master (Magistrs). Diploma Bakalaurs në mënyrë tipike zgjat 3-4 vjet dhe ka 180-240 ECTS. Diploma Magistrs është 1 deri në 2 vjet dhe vlen 60-120 kreditë ECTS. Një diplomë Master kërkohet për t' u pranuar në studime doktorature. Diploma Doktors zakonisht njihet në nivel ndërkombëtar si ekuivalente me studime doktorature Ph.D që zgjasin 3 deri në 4 vjet të plotë.

Sistemi i arsimit të lartë në Letoni aktualisht është në tranzicion. Diplomat universitare dhe Master kanë qenë programe ekskluzivisht akademike dhe kurse profesionale që çonin vetëm në diploma profesionale të arsimit të lartë. Megjithatë, në dhjetor 2000, ligji ndryshoi në frymën e Deklaratës së Bolonjës. Sipas këtyre ndryshimeve, tani mund të jepen diploma profesionale universitare (minimumi katër vjeçare me 240 kreditë ECTS) dhe diploma profesionale Master (minimumi pesë vjet studime të arsimit të lartë, dhe në total 300 kreditë ECTS). Këto përcaktime të reja bëjnë të mundur që Letonia të ketë sistem simetrik për kualifikimet dhe gradat.

Programe të arsimit të lartë profesional pasuniversitare janë programe 1-2 vjeçare me një diplomë Bakalaurs si kërkesë për t' u futur. Nëse plotësohet kërkesa që kohëzgjatja e plotë e studimeve të arsimit të lartë të mos jetë më pak se 5 vjet (ose e barabartë me 300 kreditë ECTS), këto programe ka mundësi të transformohen në programe profesionale Master gjatë reformës.

b) Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të studentëve

Për të aplikuar për vizë afatgjatë, nxënësit, studentët, studentët pasuniversitarë dhe mësuesit shoqëruar që udhetojnë për studime ose trajnime, programe shkëmbimi ose veprimtari që lidhen me shkollën duhet të dorëzojnë për ambasadën letone më të afërt:

- një kërkesë me shkrim (origjinale) ose një certifikatë regjistrimi (origjinale) nga universiteti pritës ose
- karta të studentëve ose
- vërtetim të kurseve që do të frekuentohen

Pjesëmarrësit në veprimtari shkencore, kulturore dhe artistike, programe universitare dhe të tjera shkëmbimi dhe evenimente sportive duhet të sigurojnë:

- një kërkesë me shkrim nga organizata pritëse (origjinale)

c) Lista e universiteteve dhe kolegjeve kryesore

Shihni: <http://www.aiknc.lv/en/list.php>

5. Qëndrimi

Një leje qëndrimi siguron të drejtën që një shtetas i huaj të qëndrojë në Republikën e Letonisë për një periudhë të caktuar kohore (një leje qëndrimi të përkohshëm) ose përgjithmonë (një leje qëndrimi të përhershëm). Një leje qëndrimi është e nevojshme nëse dëshironi të qëndroni në Republikën e Letonisë për një periudhë kohe që kalon 90 ditë brenda gjysmë viti duke llogaritur nga dita e parë e hyrjes. Me marrjen e lejes së qëndrimit të përkohshëm, do të duhet të paraqisni një policë të vlefshme të sigurimit shëndetësor.

Leje të qëndrimit të përkohshëm

Mund të kualifikoheni për një leje për qëndrim të përkohshëm nëse:

- jeni bashkëshort/bashkëshortja e një shtetasi leton (mund të bëheni të përhershëm pas dorëzimit të tretë të dokumenteve)
- kërkonti bashkim familjar me një anëtar të familjes në Letoni
- jeni në Letoni në lidhje me një marrëveshje punësimi (leja nuk i kalon 5 vjet)
- jeni tregtar individual ose themelues i vetëm i një shoqërie tregtare (leja nuk i kalon 5 vjet)
- jeni nëpunës i një partneriteti me të drejta nënshkruese të regjistruara në Regjistrin Tregtar (leja nuk i kalon 5 vjet)
- jeni i vetëpunësuar (leja nuk kalon 1 vit)
- realizoni punë shkencore (që nuk kalon periudhën kohore të specifikuar në planin e punës deri në 4 vjet)
- punoni në lidhje me zbatimin e një traktati ndërkombëtar ose një projekti ku Republika e Letonisë është partner (leja jepet për një periudhë kohe të nevojshme për përfundimin e projektit)
- ofroni asistencë për institucione publike dhe bashkiake të Republikës së Letonisë (leja e vlefshme për periudhën e kohës të nevojshme për të ofruar asistencë që nuk kalon një vit)
- jeni në Letoni për një trajtim (leja e vlefshme për periudhën kohore të përcaktuar në kontratën e trajtimit)
- jeni në Letoni në lidhje me veprimtari fetare (leja nuk kalon një vit)
- jeni për t'u bërë pjesë e një manastiri të regjistruar në departamentin e çështjeve fetare (leja e vlefshme për periudhë kohore që nuk i kalon tre vjet)
- studioni në një institucion arsimor të akredituar (leja jo më shumë se një vit)

Për kategori të tjera të kualifikimit për leje të qëndrimit të përkohshëm, ju lutemi shihni:

<http://www.pmlp.gov.lv/en/pakalpojumi/residence/documents.html>

<http://www.pmlp.gov.lv/en/pakalpojumi/residence/documents.html>

Kur aplikoni për leje qëndrimi, do t'ju kërkohet të dorëzoni llojet e ndryshme të dokumentacionit që varen nga qëllimi për të cilin kërkoni lejen. Për të gjetur një listë të kërkesave ju lutemi shihni faqen e internetit: <http://www.pmlp.gov.lv/en/pakalpojumi/residence/documents.html>

Për të marrë një leje qëndrimit, duhet të dorëzoni minimalisht dokumentet e mëposhtme dhe mund t'ju kërkohet të dorëzoni dokumente shtesë:

- një formular aplikimi i plotësuar (<http://www.pmlp.gov.lv/en/pakalpojumi/residence/application.html>)
- një fotografi
- një deklaratë për rezultatet e fluorografisë ose rrezeve-x
- një dëshmi penaliteti e lëshuar nga institucioni kompetent i shtetësisë ose vendit pritës (për një të huaj mbi 14 vjeç) nëse i huaji ka qëndruar në atë vend më shumë se 12 muaj;
- një dokument që konfirmon mjete të nevojshme jetese
- një dokument që konfirmon vendin e qëndrimit tuaj në Republikën e Letonisë dhe të drejtën për të qëndruar atje;
- një dokument që konfirmon pagesën e detyrimit ndaj shtetit

Nëse keni leje qëndrimi të vlefshme në Republikën e Letonisë me të paktën 30 ditë të mbetura vlefshmërie, dokumente për shtyrjen e saj duhet të dorëzohen tek:

Qendra e Shërbimit të të Huajve
Alunāna Str. 1, Rīga, LV -1050
phone: 67219650; 67219645
fax: 67219655
e-mail: aad@pmlp.gov.lv

ose në raste tjera dokumentet duhet të dorëzohen në zyrat e përfaqësisë diplomatike ose konsullore të Republikës së Letonisë (shihni pjesën 2 për vizat për informacion kontakti)

Leja e qëndrimit afatgjatë EC:

Kriteret kryesore për të marrë statusin e rezidentit afatgjatë EC janë:

- 5 vjet qëndrim i ligjshëm dhe i vazhdueshëm në Letoni përpara dorëzimit të aplikimit (me periudha mungese më të shkurtra se gjashtë muaj të vazhdueshëm dhe të mos kalojnë 10 muaj gjithsej)
- burime të mjaftueshme të qëndrueshme dhe të rregullta për të mbajtur aplikantin dhe anëtarët e familjes së tij/sak
- Njohuri të gjuhës letone

Për më shumë detaje ju lutemi shihni <http://www.pmlp.gov.lv/en/pakalpojumi/eiropa.html>

6. Procedura e Azilit

Republika e Letonisë e konsideron një person si azilkërkues nëse ai dorëzon një aplikim për të marrë azil, për shkak të frikës nga përndjekja në vendin e shtetësisë së tij ose vendit të mëparshëm pritës (nëse personi është pa shtetësi) për shkak të arsyeve të mëposhtme:

- racë
- fe
- etni
- status social
- bindje politike

Azilkërkuesi konsiderohet refugjat që në momentin ku merr statusin e refugjatit. Çdo person përveç shtetasve dhe të

huajve të ligjshëm në Republikën e Letonisë mund të aplikojë për statusin e refugjatit. Megjithatë, ky person duhet të ketë arsye të bazuara për të marrë statusin e refugjatit.

Për t'u bërë azilkërkues në Republikën e Letonisë, duhet të dorëzoni një aplikim në Gardën e Kufirit Shtetëror, në pikën e kontrollit kufitar ose në zyrat në vend. Pas dorëzimit të aplikimit, nëpunësit e Gardës së Kufirit Shtetëror do t'ju intervistojnë. Intervista bëhet për të mësuar identitetin e azilkërkuesit dhe arsyet pse ai/ajo është larguar nga vendi i qëndrimit. Për të qartësuar të gjitha çështjet e nevojshme për të vendosur nëse do të jepet apo refuzohet statusi i refugjatit, duhet të bashkëpunoni me autoritetet e përfshira në procedurën e azilit dhe të jepni të gjithë informacionin e nevojshme në fazën e vendimmarrjes. Institucionet e përfshira në procedurën e azili mund të mos e nxjerrin informacionin që ju jepni, përveç rasteve kur informacioni kërkohet nga agjenci të zbatimit të ligjit në Letoni. Nëse qëndroni në Letoni pa bazën e duhur ligjore, për shembull një vizë të vlefshme ose leje qëndrimi, mund të akomodoheni në qendrën e pritjes së azilkërkuesve "Mucenieki" gjatë kohës së shqyrtimit të kërkesës.

Vendimi do të merret brenda 3 muajve (me mundësi për të shtyrë periudhën e shqyrtimit deri në 12 muaj për arsye të bazuara) dhe do të informoheni menjëherë për këtë. Nëse ka dyshime të bazuara që azilkërkuesi nuk ka të drejtë të kërkojë azil në Letoni, kërkesa shqyrtohet brenda 2 ditëve të punës. Keni të drejtë të ankoheni kundër një vendimi negativ të Departamentit të Çështjeve të Refugjatëve në Këshillin e Apelit të Çështjeve të Refugjatëve.

Pas dorëzimit të aplikimit për të marrë statusin e refugjatit, do t'ju jepet një dokument identifikues për azilkërkues për kohën që aplikimi është në shqyrtim. Dokumenti i identifikimi siguron të drejtën e qëndrimit të azilkërkuesve në qendrën e pritjes dhe brenda territorit administrativ të saj me lejen e administratës së qendrës.

Një person me statusin e refugjatit ka të drejta dhe liri ekonomike, sociale, personale dhe të tjera si dhe përgjegjësitë e parashikuara në nenin 8 "Për të drejtat themelore të Njeriut" të Satversme (Kushtetuta e Letonisë). Përveç të drejtave të përmendura, refugjatit mund të largohet dhe të hyjë lirisht në Letoni dhe të ftojë anëtarët e tij të familjes që qëndrojnë në shtete të huaja. Për 12 muajt e parë pas marrjes së statusit të refugjatit, personi merr ndihmë për të jetuar dhe për të mësuar gjuhën e vendit, nëse refugjati nuk ka mjete të tjera jetese. Refugjatit i jepet një dokument udhëtimi që është gjithashtu një dokument identiteti dhe leje qëndrimi të përkohshëm.

Për informacion për Ligjin për Azilin në Letoni shihni: <http://www.pmlp.gov.lv/en/pakalpojumi/patverums.html>

Për informacion për qendrat e pritjes së azilkërkuesve "Mucenieki", shihni: <http://www.pmlp.gov.lv/en/pakalpojumi/asylum/mucenieki.html>

7. Bashkimi Familjar

Shtetas të huaj mund të marrin ose leje qëndrimi të përkohshëm ose leje qëndrimi të përhershëm për bashkim familjar në Republikën e Letonisë. Hyrja dhe qëndrimi i shtetasve të huaj në Republikën e Letonisë është e dokumentuar dhe mbikëqyret nga Zyra e Çështjeve të Migracionit dhe Shtetësisë, Garda e Kufirit Shtetëror, Misionet Konsullore të Republikës së Letonisë dhe Departamenti Konsullor i Ministrisë së Punëve të Jashtme në përputhje me mandatet e tyre përkatëse. Siç e përcakton ligji për imigracionin, anëtarët e familjes kanë të drejtë të aplikojnë për një leje qëndrimi të përkohshëm në Republikën e Letonisë për periudhën kohore për të cilën sponsori (gjithashtu shtetas i huaj) ka marrë lejen e tij/saj të qëndrimit.

Një bashkëshort/e, një fëmijë nën-moshë, një fëmijë nën-moshë i një bashkëshorti/e të një shtetasi apo jo shtetasi leton ose një shtetas i huaj (sponsori) që ka leje qëndrimi të përkohshëm si dhe prindërit e një shtetasi ose jo shtetasi leton dhe bashkëshortët e tyre kanë të drejtë të aplikojnë për leje qëndrimi të përkohshëm në përputhje me procedurën e Ligjit për Imigracionin. Një shtetas i huaj që dëshiron të aplikojë për një leje qëndrimi për shkak të bashkimit familjar duhet të dorëzojë në Zyrën e Çështjeve të Migracionit dhe Shtetësisë dokumentet e mëposhtme:

- Një formular aplikimi
- Një fotografi
- Një raport shëndetësor që konfirmon se shtetasi i huaj nuk ka sëmundje në dokumente normative për sëmundjet

- Një dëshmi penaliteti (nëse një shtetas i huaj është 14 vjeç ose më i madh) i lëshuar nga një autoritet i vendit të kombësisë ose vendit të qëndrimit të përhershëm nëse shtetasi i huaj ka qëndruar atje për një periudhë më të gjatë se 12 muaj
- Një dokument që verifikon që shtetasi i huaj ka mjete të mjaftueshme financiare për kohën e qëndrimit në Republikën e Letonisë
- Një dokument që verifikon vendin e paracaktuar të qëndrimit në Republikën e Letonisë dhe të drejtën për të jetuar atje p.sh pronësinë e një pronës ose kontratë qiraje
- Një certifikatë martesë nëse sponsori është bashkëshorti/bashkëshortja
- Një dokument që verifikon marrëdhënien nëse sponsori është i afërm
- Nëse aplikimi është për një fëmijë nën-moshë, një miratim i noterizuar ose leje e nënshkruar në prani të një nëpunësit të Zyrës të Çështjeve të Migracionit dhe Shtetësisë ose një Misioni Diplomatik dhe Konsullor të Republikës së Letonisë i prindit tjetër (që qëndron jashtë Letonisë) duke e lejuar fëmijën të rivendoset në Republikën e Letonisë; ose një urdhër gjykatë që përcakton që vetëm një prind (ai që udhëton në Letoni me fëmijën) është kujdestari ligjor i fëmijës dhe nuk ka kufizime në lidhje me ndryshimin e vendit të qëndrimit
- Një faturë që konfirmon pagesën e tarifës së aplikimit

Për më shumë informacion ju lutemi shihni:

Qendra e të drejtës së Migracionit: <http://cmr.jur.ru.nl/CMR/Qs/family/Latvia/>
Zyra e Çështjeve të Shtetësisë dhe Migracionit: <http://www.pmlp.gov.lv/>

8. Sistemi i Kujdesit Shëndetësor

Shërbimet mjekësore të financuara nga shteti në Letoni janë të hapura për të huajt që kanë leje qëndrimi të përkohshëm në Letoni. Ato janë gjithashtu në dispozicion të shtetasve dhe atyre që nuk janë shtetas letonë si dhe për shtetasit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian që qëndrojnë në Letoni për shkak të punësimit ose si persona të vetëpunësuar si dhe anëtarëve të familjes së tyre.

Për të marrë ndihmë mjekësore urgjente në Letoni, telefononi në 03 ose 112.

Në Letoni ka mënyra të ndryshme për të kërkuar kujdes mjekësor, që përfshijnë vizita në:

- Klinika spitalore për raste urgjente ose klinika për urgjenca ambulatorie ku kujdesi për raste urgjente jepet 24 orë në ditë
- Qendra Doktorësh që janë praktika të veçanta ose në grup të doktorëve zakonisht me vendndodhje në periferi. Një Qendër Doktorësh zakonisht ka të bëjë me praktikën e një specialisti lokal (për të rritur) i cili është zakonisht një doktor i pa-specializuar që bashku me një pediatër, dentist, mami dhe infermiere.
- Shërbime të mamive që ofrojnë shërbime parandaluese dhe urgjence
- Poliklinika ose qendra shëndetësore

9. Sistemi i sigurimeve shoqërore

E drejta për të marrë shërbime sociale dhe asistencë sociale vlen për ata që nuk janë shtetas, shtetasit e vendeve të treta dhe personat pa shtetësi të cilëve ju është dhënë numër personal identiteti në Letoni. Kjo nuk përfshin personat që kanë marrë leje qëndrimi të përkohshëm.

Kujdesi social është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Departamentit të Asistencës së Mirëqenies Sociale. Kujdesi Social përfshin ndihmë materiale, kujdes social dhe rehabilitim social.

Për më shumë informacion për t'u kualifikuar për sigurime shoqërore në Letoni shihni: <http://www.spf.lv/>

10. Strehimi

Mund të gjeni informacion për akomodim të përkohshëm në www.celotajs.lv, www.viss.lv dhe www.hostellinglatvia.com (informacion për bujtina në Letoni).

Për akomodim më afatgjatë, mund të provoni variantet *online* të gazetave të mëposhtme:

The Baltic Times (English): <http://www.baltictimes.com/classifieds/>

Neatariga Rita Avize (Latvian): <http://www.nra.lv/>

Zemgales Zinas (Latvian): <http://www.zz.lv/adverts/branches.html>

11. Njohja e diplomave

Njohja akademike është njohja e kualifikimeve të huaja për qëllim të studimeve të mëtejshme në Letoni. Qëllimi i njohjes akademike është të vlerësohet nëse aplikanti mund të vazhdojë drejtimin e zgjedhur në nivelin e zgjedhur.

Do t'ju duhet të kërkonti njohje akademike të kredencialeve të fituara në studimet e mëparshme nëse:

- Keni diplomë nga vendi juaj i origjinës dhe kërkonti të pranoheni në një fazë të mëtejshme të studimeve në Letoni
- Lëvizni nga një vend i huaj në një tjetër të për vazhduar studimet në nivelin tjetër të disiplinës tuaj
- Ktheheni në institucionin tuaj pasi të keni përfunduar një periudhë studimi jashtë

Në parim, njohja akademike kërkohet vetëm për t'u pranuar për studime të mëtejshme. Megjithatë disa aplikantë zgjedhin të marrin një vërtetim të njohjes akademike përpara se të kërkojnë punësim në profesione ku njohja e një diplome/grade të huaj nuk kërkohet zyrtarisht (pra. profesione të parregulluara). Kjo lloj njohjeje (njohje akademike për qëllime profesionale) ndihmon që punëdhënësi të kuptojë me cilin kualifikim të huaj mund të krahasohet kualifikimi nga vendi i tij.

Për të marrë njohje akademike, duhet të aplikoni në Qendrën e Informacionit Akademik (AIC) që do t'ju japë vërtetimin e saj për diplomën/gradën tuaj të huaj. Këtë vërtetim duhet ta paraqisni tek institucioni i lartë arsimor ku do të doni të studioni. Ky vërtetim mund të dorëzohet dhe tek punëdhënësit e mundshëm në profesion të parregulluara.

Sipas ligjit për arsimin- vendimi përfundimtar në lidhje me njohjen e diplomave/gradave të huaja merret nga institucioni i arsimit të lartë ku aplikanti aplikon për të vazhduar studimet e tij/saj. Ligji përcakton që institucionet e arsimit të lartë vendosin pas këshillimit me Qendrën e Informacionit Akademike të Letonisë (anëtare e rrjetit evropian të njohjes ENIC dhe NARIC).

Për të aplikuar ëpr njohje akademike, kontaktoni:

Qendra e Informacionit Akademik
Riga, Valnu iela 2, rooms 209, 210,
LV – 1050, Latvia

phone: (371) 7225155

fax: (371) 7221006

e- mail: diplomi@aic.lv (njohje akademike); izglitiba@aic.lv (njohje profesionale)

faqe interneti: <http://www.aic.lv>

12. Shërbime mbështetëse të ofruara për migrantët

IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin) Riga, Letoni

E. Pils iela 21

LV-1167 Riga, Latvia

Tel. +371-750-3626

fax: +371-750-3603

Pyetje të përgjithshme: baiba.iom@undp.riga.lv

Faqe interneti: www.iom.lv

Shoqëria e Kryqit të Kuq Letoni

Koordinon asistencën ligjore dhe sociale për azilkërkuesit dhe refugjatët.

Ms. Vineta Daugule

Skola 1, Riga, Latvia

LV-1010

Tel.: +371 733 6652

fax: +371 733 6651

e-mail: vineta.daugule@redcross.lv

UNHCR (Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët)

Pils iela 21

LV-1167, Riga, Latvia

Tel: 371-7503620

Fax: 371-7503602

Bordi i Natyralizimit i Republikës së Letonisë

1/3 Smilsu Str., Riga, LV-1050, Latvia

tel: 7229261, fax: 7210767

e-mail: np@np.gov.lv

faqe interneti: <http://www.np.gov.lv>

Këshilli i Apelimeve për Çështje të Refugjatëve

15 Raina Blvd., Riga, LV-1050, Latvia

tel: 7221546

e-mail: info@refuge.gov.lv

Bordi për Çështje të Migracionit dhe Shtetësisë

5 Raina Blvd., Riga, LV-1050, Latvia

tel: 7219181

e-mail: pmlp@pmlp.gov.lv

faqe interneti: www.pid.gov.lv/eindex.html

Shkolla e Gjuhëve, Universiteti i Letonisë

Aspazijas bulvāris 5,

Room 132 (yard building)

tel:+ 6703 4630

e-mail: valoducentrs@lu.lv

faqe interneti: <http://www.lu.lv/eng/general/structure/languages/>

13. Marrja e shtetësisë/kombësisë

Marrja e shtetësisë letone nëpërmjet natyralizimit

Aplikimi për të marrë shtetësinë letone nëpërmjet natyralizimit merret dhe shqyrtohet nga divizionet lokale të aplikantëve të Departamentit të Natyralizimit. Shtetësia letone nëpërmjet natyralizimit mund të merret nga persona të regjistruar në Regjistrin e Popullsisë dhe

- që kanë mbushur 15 vjeç;
- vendi i qëndrimit të të cilëve, datën e dorëzimit të aplikimit për natyralizim, ka qenë letonia për jo më pak se pesë vjet duke llogaritur nga 4 maji 1999 (për persona që kanë hyrë në Letoni pas 1 korrikut 1992, afati pesë vjeçar do të llogaritet nga data e dhënies së lejes së qëndrimit të përhershëm)
- që njohin gjuhën dhe historinë e Letonisë, parimet bazë të Satversme (Kushtetutës) të Republikës së Letonisë, dhe tekstin e himnit kombëtar;
- që kanë burim ligjor të ardhurash;

- që kanë dorëzuar një deklaratë për heqje dorë nga shtetësia e mëparshme dhe kanë marrë leje çatdhesimi nga vendi i shtetësisë së tyre të mëparshme, nëse kjo leje parashikohet nga ligjet e atij vendi, ose kanë marrë një dokument që vërteton humbjen e shtetësisë
- Fëmijë që qëndrojnë përgjithmonë në Letoni dhe deri në moshën 15 vjeç mund të natyralizohen së bashku me prindërit e tyre

Për të marrë shtetësinë nëpërmjet natyralizimit, duhet të dorëzoni:

- një vërtetim qëndrimi në Letoni
- që dokument që konfirmon mjetet ligjore të jetesës të tuat ose të kujdestarit, një faturë pagese të tarifave shtetërore, ose një vërtetim të lëshuar nga Departamenti i Natyralizimit që konfirmon përjashtimi nga pagesa e tarifave shtetërore.
- 3 fotografi (30mm x 40mm)
- pasaportën tuaj
- Dhe duhet të kaloni testet e gjuhës, historisë, Satversme dhe himnit kombëtar të Letonisë dhe si dhe firmosni një betim besnikërie ndaj Republikës së Letonisë.

Pasi t'ju jepet shtetësia, një shtetas i ri merr një ekstrakt nga vendimi i Kabinetit të Ministrave që vërteton që ai/ajo ka marrë shtetësinë letone që e bën të pranueshëm për të marrë pasaportën e shtetasit të Republikës së Letonisë.

Tarifa shtetërore për natyralizimi është 20, 00 LVL. Megjithatë ka përjashtime për pagesën e tarifës që varen nga e shkuara e personit dhe nga një tarifë më e ulët për përjashtim e plotë nga detyrimi për të paguar.

Testi për njohuritë në gjuhën e Letonisë ndahet në dy pjesë:

- **Pjesa me shkrim** - një aplikant, pasi merr një temë, shkruan një ese në letonisht, lexon një tekst që ka përgatitur më përpara dhe bën një test për të kuptuarin (90 minuta).
- **Pjesa me gojë** – bordi i provimit interviston aplikantin (gjuha e folur) (15 minuta).

Historia e Letonisë, Satversme dhe Himni Kombëtar i Letonisë testohen në pjesën me shkrim dhe me gojë:

- **Pjesa me shkrim** – aplikanti i përgjigjet një pyetjeje për Satversme e Letonisë, historinë dhe kulturën e saj.
- **Pjesa me gojë (test)** – aplikanti merr 18 pyetje me 3 përgjigje të mundshme për secilën prej tyre.

Tel të dyja testet, aplikanti duhet të shkruajë ose lexojë tekstin e himnit kombëtar të Letonisë. Aplikantët mbi 65 vjeç duhet të bëjnë vetëm pjesën me gojë të testit të gjuhës letone. Procedura të veçanta testimi për aplikantët me paaftësi fizike mund të caktohen.

Personat që kanë kontribuar dukshëm në zhvillimin e Letonisë- persona të përfshirë në veprimtari kulturore, shkencëtarët, sportistë, etj që nuk kanë të drejtë të natyralizohen sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar në ligjin për shtetësinë, mund të marrin shtetësinë e Letonisë sipas një vendimi të Saeima (Parlamentit) leton. Këta persona duhet të dorëzojnë aplikimet tek Saeima në fillim.

Bordi i Natyralizimit të Republikës së Letonisë

Smilšu iela 1/3, 3rd, 4th and 6th floors
Rīga, LV-1050;
Telefon 371 7814001 Fax (371) 7814005
E-mail: np@np.gov.lv

Për personat me paaftësi fizike ka procedurë të veçantë për kryerjen e testimit.

Mund të informoheni për pyetjet dhe materialet e testimit në publikimet që gjenden në:

http://www.np.gov.lv/index.php?en=info_en&saite=info_en.htm

14. Kontakte dhe informacion të tjera të nevojshme

Për listën e ambasadave përkatëse letone shihni seksionin 2 për vizat.

Ambasada e Shqipërisë për Letoninë (Poloni)

ul. Altowa 1, 02-386 Warsaw

tel: (48) 228 241 427

fax: (48) 228 241 426

e-mail: ambasada@albania.waw.pl

Ambasada e Bosnjë Hercegovinës për Letoninë (Danimarkë)

H.C. Andersens Boulevard 48-2tv,

1553 Copenhagen V

tel: + (00) 45 3333 8040

fax: + (00) 45 3333 8017

email: info@embassybh.dk

faqe interneti: www.embassybh.dk

Ambasada e Republikës së Kroacisë për Letoninë (Suedi)

Birger Jarlsgatan 13, 1 tr.

11145 Stockholm

tel: 0046 8 6788310; 678 4220; 678 3415; 678 3419

fax: 0046 8 678 8320

e-mail: eu666i@tninet.se

Ambasada e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për Letoninë (Poloni)

Krolowej Marysienki 40

02-954 Warszawa

tel: +48 22 651 72 91; +48 22 651 72 92

fax: + 48 22 651 72 92

e-mail: ambrmear@zigzag.pl

Ambasada e Serbisë për Letoninë (Suedi)

Valhallavagen 70 P.O. Box 26209

S-11427, Stockholm

tel: +468 / 218-436; 218-482; 218-485; 247-748

fax: 468 218-495